



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 33, datë 31.01.2024

PËR

**MIRATIMIN E “RAPORTI VJETOR MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT
DISIPLINOR GJATË VITIT 2023”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit Disiplinor;

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor gjatë vitit 2023”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE

NAUREDA LLAGAMI

Sektori i Organizimit të Mbledhjeve: Krisulla Kasaj


Departamenti i Shërbimeve Juridike: Blerta Ngucaj

Sekretar i Pergjithshem: Rudin Baqli

Komisioni Disiplinor: Ridvan Hado

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024



RAPORT VJETOR

MBI

VEPRIMTARINË E KOMISIONIT DISIPLINOR

PËR VITIN 2023

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	3
II. KUADRI LIGJOR	4
III. PROCEDURAT DISIPLINORE.....	4
IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË	7
V. PËRFUNDIME.....	8

I. HYRJE

Vizioni i Komisionit Disiplinor përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij është udhëhequr nga përgjegjshmëria dhe zbatueshmëria në praktikë e kuadrit ligjor për procedurat disiplinore, duke synuar realizimin e objektivave të vendosura nga vetë Komisioni në vitet paraardhëse dhe që lidhen me aplikimin e praktikave më të mira dhe standardeve të vendosura kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me procedimet disiplinore të filluara ndaj gjyqtarëve; respektimin e pavarësisë së gjyqtarëve në ushtrimin e funksioneve gjyqësore; garantimin e seancave dëgjimore publike në zbatim të parimit të një procesi të rregullt ligjor dhe parimit të drejtësisë së hapur; garantimin e barazisë së armëve, duke respektuar në nivelin më të lartë të mundshëm të drejtat procedurale të subjekteve të procedimit, dhe në veçanti ato të parashikuara në ligj për magjistratin; garantimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jo vetëm në të qenit por dhe të dukjes si i tillë; përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues, duke marrë mendime dhe sugjerime nga të gjithë grupet e interesit, qoftë me anë të takimeve apo gjatë trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për procedimet disiplinore.

Komisioni Disiplinor, si një ndër katër Komisionet e Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përgjatë vitit 2023 ka përmbushur, me përgjegjshmërinë më të lartë, të gjitha detyrat e tij, që burojnë nga aktet rregullatore ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nën dritën e objektivave të vendosura nga vetë Komisioni, si dhe referuar përcaktimeve ligjore dhe kushtetuese të neneve 147, pika 1, 147/a, pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit gjyqësor”, të ndryshuar, roli i Komisionit Disiplinor, mbetet i drejtuar në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqtarëve, në aspektin e përgjegjësisë disiplinore, për shkeljet disiplinore që lidhen me ushtrimin e funksionit si dhe jashtë tij.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 26.12.2023¹, në zbatim të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendosi mbi ndryshimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të tij. Aktualisht, në përbërje të Komisionit Disiplinor janë anëtarët e Këshillit:

- Z. Ridvan Hado, Kryetar i Komisionit
- Znj. Gentiana Muçaj, anëtare
- Z. Ilir Rusi, anëtar
- Z. Markelian Koça, anëtar zëvendësues
- Z. Alban Toro, anëtar zëvendësues.

¹ Vendimi nr. 742 datë 26.12.2023 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për një ndryshim në vendimin nr. 13 datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme” i ndryshuar.

Para datës 26.12.2023, në përbërje të Komisioni Disiplinor kanë qenë anëtarët e Këshillit znj. Marçela Shehu², në cilësinë e Kryetares dhe në cilësinë e anëtarëve z. Ridvan Hado dhe z. Ilir Rusi, ndërsa anëtarë zëvendësues z. Dritan Hallunaj³ dhe z. Alban Toro.

II. KUADRI LIGJOR

Ushtrimi i veprimtarisë së Komisionit Disiplinor normohet nga:

- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ;
- Rregullorja “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”⁴;
- Rregullorja “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”⁵

Duke u nisur nga parimet nga të cilat udhëhiqet procesi i shqyrtimit të një procedimi disiplinor, si dhe garancitë e hollësishme që i njihen palëve gjatë kësaj procedure, Këshilli dhe Komisioni Disiplinor ngarkohen me përgjegjësinë që të ofrojnë garancitë e nevojshme që kërkon e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁶, nuk pësoi ndonjë ndryshim në dispozitat e tij që kanë lidhje me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve, përgjatë vitit 2023.

III. PROCEDURAT DISIPLINORE

Komisioni Disiplinor, gjatë ushtrimit të veprimtarisë në kompetencë të tij, ka kaluar për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor 4 (katër) procedura disiplinore dhe 1 (një) procedurë të mbartur nga viti i mëparshëm. Në vijim të procedurave, nga Këshilli, është proceduar me dhënien e një vendimi jo përfundimtar lidhur me to. Konkretisht :

* **Me vendimin nr. 228, datë 11.05.2023** është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratëve B.M dhe R.A, deri në marrjen formë të prerë të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilët është disponuar dhënia e masës disiplinore “*Shkarkimin nga detyra*”, bazuar në nenin 58, pika 1 dhe në nenin 61 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

² Me vendimin nr. 737, datë 12.12.2023, Këshilli, ka vendosur deklarin e mbarimit të mandatit të anëtares znj. Marçela Shehu.

³ Me vendimin nr. 738, datë 12.12.2023, Këshilli, ka vendosur deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Dritan Hallunaj.

⁴ Miratuar me vendimin nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 166, viti 2020.

⁵ Miratuar me vendimin nr. 558, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 1, viti 2023.

⁶ Ndryshimi i fundit i këtij ligji është miratuar me Ligjin nr. 50/2021, datë 23.03.2021.

* **Me vendimin nr. 436, datë 19.07.2023** është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit S.U, për një periudhë 1 (një) vit, me qëllim përfundimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. S.U., të filluar nga Këshilli me vendimin nr. 223, datë 08.05.2023. ky procedim ishte mbartuar nga vitit 2022.

* **Me vendimin nr. 437, datë 19.07.2023** është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit S.U, për një periudhë 1 (një) vit, me qëllim përfundimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. S.U., të filluar nga Këshilli me vendimin nr. 223, datë 08.05.2023.

* **Me vendimin nr. 438, datë 19.07.2023** është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit S.U, për një periudhë 1 (një) vit, me qëllim përfundimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. S.U., të filluar nga Këshilli me vendimin nr. 223, datë 08.05.2023.

* **Me vendimin nr. 740, datë 26.12.2023** është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit K.Dh, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin është disponuar dhënia e masës disiplinore “*Shkarkimin nga detyra*”, bazuar në nenin 58, pika 1 dhe në nenin 61 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në lidhje me procedimet disiplinore, aktualisht të pezulluara, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vendimmarrjen e tij, ka vlerësuar se në kushtet kur është konstatuar ekzistenca e një shkakut kushtetues për mbarimin e statusit të magjistratit për subjektet e procedimeve disiplinore, në rrethanat kur ata janë “Shkarkuar nga detyra” nga organi disiplinor i rivlerësimit kalimtar dhe çështja e rivlerësimit ndodhet për shqyrtim përpara organit më të lartë të rivlerësimit, një rrethanë e tillë përbën shkak që, bazuar në nenin 145 të Ligjit për Statusin dhe nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative, të vendoset pezullimi i shqyrtimit të këtyre procedimeve disiplinore të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri në përfundim të çështjes së rivlerësimit përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi mbajtja ose jo e statusit të magjistratit, në kuptim të Ligjit për Statusin, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor, në kushtet kur shkarkimi nga detyra i magjistratit, përbën një nga rastet e mbylljes së procedimit disiplinor.

Ndërsa, lidhur me tre procedurat disiplinore në ngarkim të magjistratit S.U, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vendimmarrjen e tij, ka vlerësuar se në kushtet kur më herët, me vendimin nr. 223, datë 08.05.2023 të tij Këshilli ka vendosur për fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. S.U., një rrethanë e tillë përbën shkak që të vendoset pezullimi i shqyrtimit të këtyre procedimeve disiplinore të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri në përfundim të procedurës së nisur. Ndërkohë, ndaj magjistratit S.U, sipas vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton se është disponuar dhënia e masës disiplinore

“Shkarkimin nga detyra”, bazuar në nenin 58, pika 1 dhe në nenin 61 të Ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

Ndërkohë, Këshilli, lidhur me procedurat disiplinore të pezulluara më parë, ku konkretisht:

*** Me vendimin nr. 463, datë 11.10.2021** është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjstrates E.S, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin është disponuar dhënia e masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”*, bazuar në nenin 58, pika 1 dhe në nenin 61 të Ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Ky procedim vijon të jetë i pezulluar.

*** Me vendimin nr. 559, datë 01.12.2021**, për shkak të dhënies së masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”* nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj gjyqtarit R.K, deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka njoftuar Këshillin e Lartë Gjyqësor për shqyrtimin e ankimit ndaj Vendimit nr. 478, datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përfundim të të cilit me vendimin nr. 14 datë 07.04.2023 ka vendosur: *“1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 478 datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, z. R.K. 2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm”*. Në kushtet kur tashmë shkak i pezullimit të procedimit disiplinor, konsideruar nga Këshilli, në vendimin e tij nr. 559 datë 01.12.2021 për *“Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjstratit z. R.K., deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”*, ka rënë dhe nuk ekziston më, Këshilli, me propozim të Komisionit Disiplinor, me vendimin e tij nr. 660 datë 02.11.2023 vlerësoi se duhet të shfuqizohet vendimi i pezullimit dhe çështja të vijojë të trajtohet nga Mbledhja Plenare e cila do të duhet tashmë të zgjidhë në themel çështjen.

Në Mbledhjen Plenare të datës 21.11.2023, Këshilli me vendimin nr. 694 ka vendosur përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjstratit z. Rexhep Karaj, pa një vendim përfundimtar. Këshilli në vendimmarrjen e tij arsyetoi se në kushtet kur z. R.K. nuk e gëzon më statusin e magjstratit, nuk mund të jetë më objekt i veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, për rrjedhojë shqyrtimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj tij, duhet ndërprerë pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur, mbështetur në nenet 147,147/a, 179/b, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 64, 134, 139 të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, nenet 97, 98 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

*** Me vendimet nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë** është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit M.K, referuar faktit se, çështja objekt inspektimi ishte në shqyrtim në Gjykatën e Lartë pas ushtrimit të së drejtës së rekursit nga palët dhe ende nuk kishte përfunduar.

Pas shqyrtimit të akteve, në kushtet kur tashmë shkak i pezullimit të procedimit disiplinor, konsideruar nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vendimet e tij nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013, ka rënë dhe nuk ekziston më, nga Komisioni Disiplinor u vlerësua se janë kushtet e shfuqizimit të vendimeve të pezullimit. Gjithashtu, me rënien e shkakut të pezullimit dhe shfuqizimin e vendimeve përkatëse rezulton se tashmë nuk ekziston asnjë shkak që të pengojë shqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor. Këshilli, me propozim të Komisionit Disiplinor, me vendimin e tij nr. 702 datë 30.11.2023 ka vendosur shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta” dhe vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit z. M.K.

Në vijim, Këshilli pasi shqyrtoi aktet e procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. M.K, me vendimin nr. 723 datë 07.12.2023 ka vendosur mbështetur në nenet 147,147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 117, 139 dhe 172 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86, shkronja “e”, nenet 97, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. M.K., për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara, për të cilat ka nisur ky procedim.

Këshilli, në vendimmarrjen e tij ka arsyetuar se shkeljet e pretenduara për të cilat ka nisur procedimi disiplinor ndaj magjistratit M.K., dhe të cilat kanë të bëjnë me vendime gjyqësore të vitit 2009 dhe 2012, janë parashkruar. Instituti i parashkrimit shuan të drejtën e organit disiplinor të hetojë dhe të japë vendim për masë disiplinore ndaj magjistratit për shkak të kalimit të një kohe të gjatë nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore, afat i cili llogaritet nga momenti i kryerjes së shkeljes së pretenduar. Respektimi i afatit të parashkruar për kryerjen e procedimeve disiplinore është në funksion të garantimit të parimit të sigurisë juridike.

IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Në aspektin e rritjes së cilësisë së vendimmarrjes dhe performancës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, bashkëpunimi ndërinstitutional, në çështjet me natyrë disiplinore mbetet në vëmendje të veçantë të Komisionit Disiplinor. Janë vlerësuar tryezat e përbashkëta të organizuara me institucione të tilla të pavarura si Këshilli i Lartë të Prokurorisë apo Inspektori i Lartë të Drejtësisë, të cilat kanë patur si qëllim diskutimin e rolit të shërbimeve të inspektimit, si garantues për funksionimin e drejtë dhe të pavarur të sistemit të drejtësisë dhe magjistratëve, sipas standardeve evropiane dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Në plotësim të rekomandimeve të vendosura në Rezolutën e Kuvendit për vitin 2023, Komisioni Disiplinor, konkretisht lidhur me pikë 10, kërkoi mbështetje nga Projekti EU4Justice, nga takimet me përfaqësuesit e të cilit u dakordësua për ngritjen e një grupi pune, i cili do të përbëhej nga Komisioni Disiplinor i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni Disiplinor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe përfaqësuesit e EU4Justice dhe u titullua Working Group of ‘Drafting of a Joint Regulation on Unified Disciplinary Proceedings for Violation Cases Involving a Judge and a Prosecutor (Art 140/2 of Law 96/2016)’. Pas disa takimeve të zhvilluara, është arritur të hartohet një draft paraprak, i cili vijon të jetë në përpunim e sipër, pas propozimeve dhe diskutimeve të ndryshme nga përfaqësuesit e grupit të punës.

Ndërsa, lidhur me rekomandimet e lëna për Këshillin në pikën 11, ku duhet të kontribuojë nëpërmjet kërkesave të motivuara dhe të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për hartimin e planit vjetor të inspektimeve tematike në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, veçanërisht në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para Ligjit dhe parimit të proporcionalitetit” rezulton se nuk ka pasur ndonjë kërkesë specifike nga Këshilli për inspektime tematike.

V. PËRFUNDIME

Komisioni Disiplinor si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kanë treguar përgjegjshmëri dhe kujdes në zbatueshmërinë në praktikë, të gjithë kuadrin normues për procedurat disiplinore, duke përfunduar brenda afateve ligjore dhe të arsyeshme të gjitha procedurat disiplinore të paraqitura për shqyrtim.

Në objektivat e Komisionit Disiplinor, si dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2024, mbetet përfundimi i procedimeve disiplinore, të cilat janë të pezulluara për shkak të dualitetit të procedimeve disiplinore ndaj magjistratëve, për periudhën e përkohshme, në kushtet kur është vlerësuar se magjistrati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë nën disa hetime ose procedime disiplinore të veçanta, kjo për shkak të ndikimit që ato kanë lidhur me sanksionin disiplinor sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 115, të Ligjit për Statusin.

Në plotësim të rekomandimeve të vendosura në Rezolutën e Kuvendit për vitin 2023, Komisioni Disiplinor synon të arrijë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Komisionin përkatës, finalizimin në vitin 2024 e një drafti përfundimtar me rregulla të përbashkëta për bashkimin e procedimeve, për rastet kur një gjyqtar ose një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore.

Në fokus të Komisionit Disiplinor, ka qenë dhe do të vijojë të jetë, me anë të propozimit të temave trajnuese me objekt çështje të rëndësishme të disiplinës, bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, në drejtim të organizimit të trajnimeve të përbashkëta.

